



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 242/2 Prot

Tiranë, më 30.05.2022

V E N D I M

Nr. 77, datë 30.05.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, nr. 17715, datë 7.10.2021, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit doganor *** dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

Vërej se:

Nëpërmjet një kërkesë, të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 242 prot., datë 28.3.2022, nga nëpunësi doganor *****, është ngritur pretendimi se, megjithëse ka mbaruar afati maksimal 6-mujor i transferimit të tij të përkohshëm në pozicionin “Doganier, Zyra e Mbikëqyrjes së Magazinave Fiskale dhe Prodhimit”, Dega Doganore Fier, nga ana e institucionit, nuk është vepruar për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, prandaj është kërkuar ndërhyrja e Komisionerit për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

Nga hetimi administrativ i këtij rasti, vërtetohet se, pas kryerjes së ristrukturimit të fundit në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, pasi ka shqyrtuar propozimet e Komisionit të Ristrukturimit të DPD, ndërmjet të tjerave, me aktin nr. 1793/4, datë 26.3.2019, ndër të tjera ka miratuar

transferimin e përhershëm të nëpunësit doganor *****, në pozicionin “*Doganier në Sektorin e Vlerës në Qendër*”, në Drejtorinë e Vlerësimit në Qendër, pranë DPD dhe mbi këtë bazë, ka dalë akti nr. 7655/1, datë 27.3.2019, i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, për emërimin e tij në pozicionin e mësipërm.

Veprimet e mësipërme janë kryer në përputhje me rregullat e përcaktuara për rastet e ristrukturimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe dispozitat e legjislacionit doganor (pika 8, e nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar), ku parashikohet shprehimisht që në administrimin e shërbimit doganor, krahas dispozitave të posaçme të Kodit Doganor, zbatohen edhe dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil.

Pasi ka marrë emërimin e mësipërm, rezulton se, nëpunësi, me aktin nr. 17715, datë 7.10.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, është transferuar përkohësisht, për nevoja të institucionit, në pozicionin “*Doganier, Zyra e Mbikëqyrjes së Magazinave Fiskale dhe Prodhimit*”, Dega Doganore Fier (ku vazhdon të punojë aktualisht).

Për shkak se afati maksimal 6-mujor i transferimit të përkohshëm, ka mbaruar dhe nga ana e institucionit nuk është vepruar, nëpunësi doganor *****, ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë dhe kthimin e tij në vendin e punës si “*Doganier në Sektorin e Vlerës*”, në Drejtorinë e Vlerësimit në Qendër, pranë DPD, ku ka emërimin e rregullt.

Në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të transferimit të përkohshëm në këtë rast, që në momentin e parë evidentohet fakti që, për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, në legjislacionin specifik të tij (pika 3 e nenit 13, të Kodit Doganor), janë parashikuar rregulla të posaçme, si në drejtim të llojeve të transferimeve, periodicitetit të tyre ashtu dhe të organit kompetent që urdhëron këto transferime.

Konkretisht, pika 7, e nenit 15, të këtij kodi, në shkronjën “a” parashikon: “*Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:*

- i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj;
- ii) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj;
- iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzanisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës.

Siç shihet, në germën “i”, të nenit 15, pika 7/a, të ligjit 102/2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, është hequr kufizimi i dispozitës së ngjashme të pikës 1/a, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, sipas së cilës mund

të bëhet një transferim i përkohshëm i një nëpunësi deri në 6 muaj (*njëherësh ose e copëzuar*) për nevoja të punës, por kjo jo më shumë se një periudhë 6-mujore, gjatë dy viteve. Kjo do të thotë që, një nëpunës doganor mund të transferohet përkohësisht, për nevoja të institucionit, sa herë lind e nevojshme diçka e tillë, pa patur ndonjë kufizim të shprehur ligjor në shpeshtësi.

Por nga ana tjetër, duke e parë në brendësi përmbajtjen e aktit nr. 17715, datë 7.10.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, rezulton se ky transferim i përkohshëm, është bërë për nevoja të institucionit (*pika 7, shkronja “a” (i), e nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i RSH”*) por në akt nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur afati i transferimit.

Në lidhje me këtë mangësi, nga ana e institucionit arsyetohet se, meqë dispozita referuese e aktit e parashikon në mënyrë të shprehur afatin maksimal të një transferimi të përkohshëm, kohëzgjatja prezumohet që nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj. Megjithatë, kjo mangësi vlerësohet si një element paligjshmërie i aktit të transferimit, pasi si rregull në akt duhet të përcaktohet në mënyrë të shprehur koha e transferimit të përkohshëm dhe data e kthimit të nëpunësit në pozicionin e mëparshëm, gjë e cila do të siguronte një stabilitet në marrëdhënien e punësimit në shërbimin civil dhe transparencën e nevojshme, duke i siguruar nëpunësit mundësinë që të kërkojë konkretisht rivendosjen e të drejtës së tij.

Shkelja e mësipërme e kryer në hartimin e këtij akti, ka krijuar kushte më pas, për mosrespektimin e pikës 7/c, të nenit 15, të Kodit Doganor, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur: *“Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi kthehet në pozicionin e mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur nëpunësi pranon të vijojë në pozicionin ku ishte transferuar”*.

Në kushtet aktuale, kur vërtetohet që afati 6-mujor i transferimit të nëpunësit ***** , ka përfunduar, si dhe kur nuk kemi të bëjmë me ndonjë rast përjashtimor të parashikuar në ligj, ky punonjës duhej të ishte rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, duke theksuar detyrimin që, nëpunësi doganor mund të transferohet përkohësisht, për një afat tjetër, në vazhdim apo me përsëritje, vetëm në kushtet e ekzistencës së nevojës së domosdoshme institucionale, të argumentuar, duke përcaktuar saktë afatet dhe duke mbajtur parasysht parimet e proporcionalitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, parashikuar përkatësisht në nenet 12 e 17, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, *“Mbi*

procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga organi publik, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin përkatës administrativ, për kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e punës “*Doganier në Sektorin e Vlerës në Qendër*”, në Drejtorinë e Vlerësimit në Qendër, pranë DPD, ku ai ka emërimin e rregullt, për shkak se është plotësuar afati maksimal 6-mujor i transferimit, në zbatim të shkronjës “a”, pika 7, të nenit 15, të ligjit nr.102/2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar.
2. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **15** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, njësia e burimeve njerëzore të institucionit është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha